

Thirrje për Kandidatura për Manaxher Projektsh

Pozicioni:	Menaxher Projektsh
Kohëzgjatja e kontratës:	1 vjecare e rinovueshme (me 3 muaj provë)
Fillimi i punës:	15 Prill 2016
Afati i fundit i aplikimit:	10 Prill 2016

Organizata

Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI) është një organizatë jo-qeveritare e themeluar në Shqipëri në vitin 2000. Organizata ka një rekord unik të arritjeve në prodhimin e evidencës dhe të dhënave të nevojshme në përgatitjen dhe vlerësimin e politikave publike dhe aktiviteteve në ngritjen e kapaciteteve të institucioneve relevante. Qëllimi kryesor është kontributi profesional në zhvillimin socio-ekonomik dhe i politikave publike drejt një ekonomie eficiente dhe një shoqërie solidare.

CDI përdor portalin [Shtetiweb](http://www.shtetiweb.org) për të ruajtur, ndër-lidhur dhe publikuar informacionin e duhur mbi nivelet e ndryshme të qeverisjes në Shqipëri. Forumi Curiaweb shërben për tu konsultuar me profesionistët dhe publikun mbi tema specifike, si dhe për të përgatitur dokumente politikash për nivelin politik-bërës.

CDI është Zyra e Koordinimit Kombëtar e Programit PERFORM në Shqipëri, që mes të tjerash synon rritjen e impaktit të hulumtimit shkencor në politikë-bërje.

CDI ka ndërtuar një ekspertizë të pasur dhe një rrjet partnerësh strategjikë në:

- Studimet mbi BE-së dhe procesin e zgjerimit të BE-së, me një fokus të veçantë në procesin e aderimit të Ballkanit Perëndimor;
- Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkufitar;
- Qeverisjen e mirë në nivel qendror dhe vendor, reformat e decentralizimit dhe politikat sociale;
- Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Ngritjen e Kapaciteteve, kryesisht për aktorët jo-privatë;
- Hulumtim dhe zhvillimin e politikave sektoriale specifike bazuar në njohurinë dhe ndërveprimin me përfituesit finalë, dhe në partneritet të ngushtë me organizata komunitare.

Instrumentet kryesore të përdorura nga CDI gjatë punës janë:

- Debati publik dhe angazhimi qytetar përmes informimit, edukimit dhe sensibilizimit;
- Hulumtimi i aplikuar dhe analiza e politikave, trajtuar me metoda statistikore moderne;
- Menaxhimi i ciklit të projektit dhe mbështetje teknike (menaxhimi financiar, raportimi, prokurimi dytësor);
- Zhvillimi i burimeve njerëzore dhe ndërtimi i kapaciteteve.

Profili i punës

Në kuader të aktiviteteve të CDI, kërkohet një person për pozicionin e Menaxherit të Projekteve. Nën udhëheqjen e Menaxherit të Programit të Institutit për Bashkëpunim dhe Zhvillim/ ShtetiWeb, detyrat kryesore të Projekt Menaxherit përfshijnë (por nuk limitohen në):

- Të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme portofolin e aktivitetit kërkimor mbi BE, bashkëpunimin rajonal dhe Procesin e Berlinit;
- Të menaxhojë dhe/ose mbështesë projekte me natyrë kërkimore të Institutit mbi tematikat prioritare të zhvillimit socio-ekonomik dhe integritit të Shqipërisë në BE;
- Të bashkëveprojë me kolegët në drejtim të nismave mbi politikëbërjen e bazuar në evidenca dhe hulumtim shkencor;
- Të mbajë kontakte të vazhdueshme me partnerët në vend dhe rajon;
- Të kontribuojë në përditësimin e informacionit në faqen e internetit (kur nevojitet).

Profili i kandidatit

- Të diplomuar me gradë M.A/M.Sc. në shkenca politike, marrëdhënie ndërkombëtare ose të ngjashme (preferencë kanë të diplomuarit jashtë vendit);
- Eksperiencë relevante në fushën e kërkimit shkencor dhe njohje shumë të mirë të metodave të kërkimit;
- Aftësi shumë të mira analitike, hulumtuese dhe draftuese;
- Aftësi për kontakte dhe rrjetëzim me partnerët strategjikë dhe përfituesit;
- Eksperiencë të paktën dy vjeçare në menaxhim projektësh;
- Njohje shumë të mirë të gjuhës angleze;
- Aftësi shumë të mira komunikuese dhe pune në grup;
- Njohja e një programi statistikor (si SPSS, STATA, R, etj.) është e preferueshme;

Aplikimi

Të interesuarit janë të lutur të dergojnë CV (max. 3 faqe) dhe një **letër interesi**, brenda datës **10 Prill 2016**, në adresën elektronike: info@cdinstitute.eu.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur paraprakisht do të kontaktohen për intervistë.